



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 4-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur me
28. 03. 2014 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini , anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi , anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Xhevat Olluri, anëtar
10. Rizah Bajraktari, anëtar
11. Ukë Kryeziu, anëtar
12. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar
14. Blerim Gashi, anëtar
15. Albulena Gashi, anëtar
16. Florent Hoxha, anëtar
17. Petrit Kelmendi, anëtar
18. Ragip Zejnullahu, anëtar
19. Nazmi Krasniqi, anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Burbuqe Ilazi, anëtar
24. Vlora Buja, anëtar
25. Arben Bahtiri, anëtar
26. Edita Gashi, anëtar
27. Ramiz Qeriqi, anëtar
28. Zoran Çirkoviq, anëtar
29. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkyetar për Komunitete
3. Shkelzen Hajdini, Drejtor DBF
4. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
5. Remzi Mehmeti, DMSH
6. Avni Olluri, Drejtor, DGJK
7. Feti Krasniqi, Drejtor i DBPZHR
8. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
9. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
10. Adem Duriqi, Drejtor i DP
11. Fauzë Xhemajli, Drejtor i administratës
12. Heset Sahiti, Drejtor i SHP
13. Qëndresa Jashanica, Shefe e Kabinetit të Kryetarit
14. Ahmet Maksuti, zyra ligjore
15. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
16. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
17. Mefail Mustafa, OSBE
18. Bekim Krasniqi, OJQ"YAHR"
19. Alban Nuredini, zyra për informim
20. Përfaqësuesit e mediave
21. Naser Bytyqi- përkthyes, shqip-serbisht
22. Haki Avdiu, Operator për zërim dhe inqizim të mbledhjes

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezantojnë 22 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Me që askush nuk lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje, Kryesuesja të njejtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me shumicën e votave për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 3-të e KK-së
2. Shqyrtimi i propozim Rregullores për taksa komunale
3. Shqyrtimi i propozim Rregullores për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për ndarjen e subvencioneve nga Buxheti i Komunës
4. Shqyrtimi i propozim Rregullores për shfuqizimin e Rregullores për lejet për ushtrimin e veprimtarive afariste
5. Shqyrtimi i Planit Vjetor të Veprimit të KKS-së për vitin 2014 i Komunës së Lipjanit
6. Shqyrtimi i propozim Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
7. Shqyrtimi i propozim Vendimit për themelimin e Komisionit vlerësues për dhënjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit
8. Shqyrtimi i propozim Vendimit për formimin e Komisionit të ankesave

Para se të kalohet në punë sipas rendit të ditës së aprovuar, Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush ndonjë pyetje për ekzekutivin.

Florent Hoxha, ne si grup parlamentar i PDK-së kemi kërkuar nga MAPL për interpretim ligjor të Vendimit për emërimin e Nënkryetarit shtesë për komunitete dhe neve nuk na ka ardhur përgjigje nga ju kurse nga MAPL e kemi përgjigjen e gjithashtu edhe për emërimin e anëtarëve në KPF sipas çelsit të MAPL përqindja e PDK-së është 3.52 dhe prej jush na është thenë se përqindja mbi 3% e kemi marrë dhe i kemi dhënë komunitetit jo shumicë. Në vazhdim kërkoj që nga Drejtorati për shëndetësi për mbledhjen e ardhshme të paraqitet një informatë për gjendjen në shëndetësi e gjithashtu kërkoj që të na informoj për shkarkimin e dy shefave në QKMF. Pastaj tha se qytetarët e Shalës kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me mbylljen e kanalizimit në 3 vende e gjithashtu kanë shprehur shqetësimin lidhur me problemet që janë shfaqur me personat fizik lidhur me pusët që janë hapur për ujësjellës dhe për këto dy çështje kërkoj nga institucionet e komunës që të mirren masa.

Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese, sa i përket komunitetit serb ata e kanë një përfaqësues në Kuvend, andaj ju ka takuar edhe një anëtarë në KPF, ndërsa sa i përkeq përqindjes të njejtën ua kam thenë edhe unë, kurse përgjigje tjetër nuk kam marrë nga MAPL.

Florent Hoxha, në mbledhjen e kaluar ju keni thenë se PDK-ja ka 3.45% dhe besoj se është inqizimi dhe unë në javën e ardhshme do të kërkoj takim edhe me ju edhe me Kryetarin e Komunës për këtë çështje dhe do t'i caktojme anëtarët në Komitete në mënyrë që të japim kontributin tonë.

Nazmi Krasniqi, kërkoj që në takimin e ardhshëm të Kuvendit të paraqitet një informatë për gjendjen në arsim ku do të përfshihet suksesi i nxënësve dhe pranimi i kuadrit mësimor si dhe pranimi i drejtorëve gjatë këtyre tre muajve.

Nehat Tërpeza, kërkoj hartimin e një Rregulloreje të re për transportin e udhëtarëve dhe kërkoj që të vazhdohet edhe për një vit afati i vijave të regjistruara.

Heset Sahiti, na kemi bërë një kërkesë në Ministrinë e Transportit në mënyrë që të na informojnë se a do të ndryshohet Rregullorja për transportin e udhëtarëve dhe a do të vazhdohet afati i vijave.

Sa i përket shqetësimeve të fshatit Shalë na i kemi të gjitha informatat jo vetëm për Shalë por për të gjitha defektet e kanalizimeve në të gjitha fshatrat.

Enver Kozhani, unë po e paraqes shqetësimet e qytetarëve të fshatit Gadime e Ulët lidhur me transportin e zhavorit nga gurëthyesit të cilët paraqesin rrezik edhe për udhëtarët edhe për ambientin e gjithashtu bëhet edhe shkatërrimi i rrugës, andaj kërkoj që kjo çështje të zgjidhet sa më parë.

Xhavid Maholli, për çështjen që paraqiti parafolësi unë kam bërë kërkesë me shkrim por gjerë më tani kjo çështje nuk është zgjidh dhe nuk bën të zvoglohet asnjë ton por të bëhet një zgjidhje me rrugë alternative me që rruga veq tani është shkatërruar. Çështje tjetër është edhe mungesa e ujit dhe kërkoj që çështja e ujit së shpejti të zgjidhet nga Drejtorati përkatës.

Feriz Hasani, paraqiti shqetësimin e tij dhe qytetarët e fshatit Glllogovc lidhur me anashkalimin e përfundimit të punëve të shkollës në Glllogovc me mjetet që kanë qenë të parapara nga Ministria e arsimit në shumën prej 600 mijë euro ku prej këtyre mjeteve ka qenë e planifikuar përfundimi i shkollës së Glllogovcit, Banullës dhe Bujanit kurse tani është hjekë Glllogovci, andaj kërkoj që deri në qershor me rishikim të buxhetit të përfshihet edhe shkolla e Glllogovcit.

Ali Stublla, kërkoj që nga buxheti i komunës të ndihmohen klubet sportive e që gjerë me tani Komuna nuk i ka ndihmuar Klubet.

Merita Zeqiri, kërkoj nga Drejtori i arsimit që të përgatit një informatë për Kuvend lidhur me çështjen e pedagogëve në Komunën tonë sepse të gjithë pedagogët që kanë kryer fakultetin kanë një shqetësim. Pastaj tha se në javën e kaluar është mbajtur një takim për barazi gjinore dhe shumë pak femra kanë marrur pjesë, andaj kërkoj nga të gjithë deputetët edhe të tjerët që ta mbajnë një séanceë për qështjen e barazise gjinore.

Arben Bahtiri, sigurisht se ka shumë kërkesa por unë do t'i ngris dy çështje si vijon:

- Pse po ndodhin reduktime të shpeshta të ujit dhe

- Te rruga 4 kursi në mesë të 2 vijave të asfaltit është krijuar baltë dhe mendoj se me pak mjete mund të rregullohet, gjithashtu kërkoj që të reduktohet edhe numri i kafiterive.

Heset Sahiti, Drejtor i SHP, ndërmarrja e ujit i ka politikat e veta për kursim të ujit por së shpejti do të hapen edhe 2 puse të ujit dhe besoj se nuk do të ketë kaq reduktime.

Sa i përket rrugës 4 kursi vija që e ndanë rrugën do të bëjmë përpjekje për gjelbrim të saj.

Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së, sa i përket pyetjes së Feriz Hasanit për shkollën e Gllgovcit ne kemi kërkuar në Ministrin e arsimit që të fusim edhe shkollën e Gllgovcit por Ministria nuk ka pranuar.

Me që pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikes së pare.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 3-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 3-të të Kuvendit?

Nazmi Krasniqi, në ekstrakt një pjesë e diskutimit tim nuk është përfshi ku kam thënë renovimi i shkollës "Vllëzërit Frashëri" dhe garat e shkollës "Ismajl Luma" ku kemi zënë vendin e parë kërkoj që të përfshihen në ekstrakt.

Pasi vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht,

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 3-të të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Shqyrtimi i propozim Rregullores për taksa komunale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Latif Ramadanit Drejtor i DEZH i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Rregullorja e cila sajton pjesën përbërse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, falenderoj Drejtorin për paraqitjen e kësaj Rregullore dhe ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë Rregullore me që lehtësime krahasuar me Rregulloren e mëparshme.

Xhevat Olluri, fillimisht falenderoj komisionin për hartimin e kësaj Rregulloreje dhe dashta ta jap kontributin tim për ndryshim të disa taksave si shembull: te administrata për lëshimin e dokumenteve zyrtare, dokumente që vihen në dispozicion për publikun që kërkon më shumë se 20 faqe duhet të vëhet një taksë.

Te vërtetimet për bashkësinë familjare, për çertifikata ekonomike, për çlamërimin dhe lajmërimin e vendbanimit për lirim nga shtetësia etj. duhet të vëhet një taksë.

Të dallohen kërkesat që kanë të bëjnë me udhëheqjen e procedurave administrative dhe tarifa të jetë 2 euro.

Për ankesat që parashetrojnë në organet e administratës ankesat të jenë falas (pa taksë).

Te liri nga obligimi i pagesës së taksës për anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të të zhdukurve të UÇK-së dhe invalidëve të luftës të UÇK-së të përfshihen në këtë rubrikë edhe anëtarët e personave të zhdukur dhe personave me aftësi të kufizuar.

Te taksat për regjistrimin e automjeteve që është sipas tonazhës duhet të veçohen motocikleta dhe taksa të jetë 5 euro e jo 10 euro.

Te taksat për ushtrim të veprimtarisë paisjet për shitjen e akulloreve, misrit, gështenjave ngarkesa është bërë në bazë mujore 5 euro për m², ndërsa për dhënjën në shfrytëzim të sipërfaqeve para objekteve të biznesit për veprimtarinë e cila është lejuar të ushtrohet jashtë objektit dhe ekspozimi i mallërave të lejuara, ngarkesa është bërë për bazë mujore 1 euro për m², ndërsa te tavolinat lëvizëse për shitjen e urimeve, panoramave, fotografive artistike ngarkesa është bërë në bazë ditore 1 euro m², andaj kërkoj që këto të barazohen.

Florent Hoxha, si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë Rregullore dhe është parë se kjo Rregullore është nxjerr nga Rregullorja e mëparshme dhe përafërsisht është e njëjtë.

Te neni 6 pika 5 taksa është parapa 3 euro na propozojmë që të jetë 1 euro dhe këtë e themi për shkak se para luftës regjistrimet e mëvonshëm në rexitrat e gjendjes civile kanë pasur shumë gabime.

Te pika 10 dhe 11 propozojmë që taksa e paraparë prej 8 euro të caktohet 5 euro.

Te pika 17 thuhet kushtet minimale dhe unë mendoj se duhet të hiqet kushtet minimale.

Te neni 7 pika 3 flitet për lirimin e pagesës së taksës për automjete në pronësi për organizatat të cilat janë përmend dhe propozoj që në këtë pasus të përfshihen edhe familjet e të martirizuarve, invalidët e luftës dhe veteranët e UÇK-së si dhe të burgosurit politik, gjithashtu kërkoj që në nenin 7 paragrafi 3 të hiqet fjalia të zhdukurve të UÇK-së me që nuk dihet se çka nënkuptohet me të.

Latif Ramadani, gjatë hartimit të kësaj Rregullore ne kemi konsultuar me të gjitha drejtorit dhe kemi konstatuar se me lirimin e bizneseve nga taksa do të krijohen kusht për një punësim më të madh. Sa i përket lirimit nga taksa të organizatave dhe shoqatave të ndryshme na strikt ju kemi përmbajt ligjit dhe me Ligj thuhet familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK- mirëpo për këtë do të konullohem edhe me zyrën ligjore dhe ndoshta do të kërkojmë edhe nga niveli qëndror që nëse ka mundësi me u përmirësu kjo.

Blerim Gashi, është një hap i guximshëm për lehtësimin e bizneseve dhe mendoj se është një çasje pak më ndryshe ndaj bizneseve dhe unë e përkrahu këtë Rregullore dhe duhet ta inkurajojmë ekzekutivin që mos të ketë dallime apo diskriminim ndaj disa bizneseve por të gjitha të trajtohen në mënyrë të barabart.

Te shfrytëzimi i hapësirave publike nga lokalet afariste shuma për m² prej 1 euro duhet të rritet në 2 euro m².

Ukë Kryeziu, këtu po diskutohet edhe për pikën e parë edhe për të dytën, andaj është mirë të shqyrtohet pika e parë e pastaj e dyta. Në Rregullore është thënë të zhdukurit e UÇK-së dhe unë kërkoj që zyra ligjore për këtë të kërkon interpretim se çka nënkuptohet me fjalën të zhdukurit e UÇK-së.

Ali Stublla, me nenin 10 të kësaj Rregullore parashihen taksat për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve Rini, Sport dhe Kulturë dhe unë propozoj që për këto dy kategori të hiqen taksat.

Agron Hajdini, te neni 8 i kësaj Rregullore mendoj se është i qartë caktimi i taksave dhe nuk ka asnjë arsye as për zvogëlim as për rritje të këtyre taksave.

Arben Bahtiri, çështje e parë ka të bëjë me eksponimin e librave dhe unë kërkoj që të hiqet taksa për këtë destinim.

Te taksat për shfrytëzimin e sallave propozoj që të është e njëjtë për të gjitha subjektet politike me që më heret disa subjekte nuk kanë paguar fare.

Me që diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike Kryesuesja vuri në votim propozimin e Rregullores dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 vota për 9 kundër miratoi këtë:

Rregullore për taksa komunale

Shtesë: Rregullorja.

III

Shqyrtimi i propozim Rregullores për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për ndarjen e subvencioneve nga Buxheti i Komunës

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Basri Hashanit Drejtor i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullora e cila sajton pjesën përbërëse të këtij procesverballi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Daut Azemi, ne si grup parlamentar i LDK-se e mbështesim këtë Rregullore për subvencione e cila gjerë me tani nuk ka qenë.

Hajrije Salihu, edhe ne si grup parlamentar i Nismës për Kosovën e përkrahim këtë Rregullore me disa vërejtje.

Te Kryetari shuma e subvencioneve që mund të ndaj Kryetari është 20 mijë euro e që më herët nuk ka qenë kështu dhe ndarja e subvencioneve nuk është bërë në mënyrë të drejtë. Te kultura unë e di që është klubi letrarë “Falzi Grajçevci” dhe nuk e di që a është ndihmuar ndonjëherë. Te shëndetësia ishte një kriter ku kërkohet kartela e asistencës sociale dhe unë propozoj që mos të merret si kriter. Në fund tha se besoj që me këtë Rregullore do të përfitojnë njerëzit që kanë nevojë.

Blerim Gashi, edhe ne e përshëndesim këtë Rregullore se në vitin e kaluar nga auditori kemi pasur vërejtje për ndarjen e subvencioneve dhe është kërkuar që të nxirret kjo Rregullore.

Te shëndetësia kartela e asistencës sociale ndoshta është e nevojshme por mos të jetë e domosdoshme.

Nazmi Krasniqi, nga parafolësit u tha se është mirë që është propozu kjo Rregullore, por sa është e zbatueshme nuk mund të themi sepse dy parafolësit e mëparshëm kanë intervenu te unë për ndarje të subvencioneve.

Florent Hoxha, në mandatin e kaluar nga Kryetari i Komunës është formuar një komision i cili në bazë të kërkesave të parashtruara ka ndarë subvencionet. E tha edhe Nazmiu se kërkesat janë shumë më të mëdha se sa mundësitë. Pastaj kërkoj që të gjitha Vendimet për ndarjen e subvencioneve të jenë transparente dhe të publikohen në Web faqen e komunës, e gjithashtu në kuadër të zyrës së Kryetarit të subvencionet të futen edhe shoqatat e dalura nga lufta në mënyrë që të subvencionohen për mallëra dhe shëbime ashtu siç i kemi subvencionuar më parë. Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë Rregullore.

Xhevat Olluri, është mirë që një pjesë të subvencioneve të ketë edhe Drejtoria e arsimit për ndarje të bursave apo ndihmës për student të lëmive të caktuara me notë mesatare mbi tetë.

Florent Hoxha, te shëndetësia shuma prej 500 euro për subvencione kjo është edhe e rregulluar me Ligj.

Për student u tha për ndarje të bursave që nota mesatare tëjetë mbi tetë unë propozoj nën tetë.

Nazmi Krasniqi, që për bursa të studentëve të nxirret një Rregullore e veçant për kuadra të lëmive të veçanta siç është matematika etj. dhe mos të jetë kriter nota por të përfshihen edhe rastet sociale.

Arben Bahtiri, e përkrahu këtë Rregullore dhe kërkoj që subvencionet të jenë transparente dhe të paraqitet raport lidhur me shpenzimin e këtyre mjeteve.

Ali Stublla, gjatë diskutimeve u tha se duhet të paraqitet raport për shpenzimet e mjeteve për klubet e sportit por na nuk mund të paraqesim raport për shpenzimet financiare të klubeve të financuara nga donatorët.

Ramiz Qeriqi, unë e kam vetëm një votë dhe nuk qonë pesh vota ime se ku votoj por me rëndësi është të dihet se ku kam votu. Sa u përket subvencioneve është mirë që të formohet një

komision nga Komuna që të kontrolloj këto mjete me që në të kaluarën janë ndarë mjete shoqatave dhe ato mjete janë keqpërdorë, andaj duhet të dihet se ku kanë shkuar ato mjete.

Petrit Kelmendi, unë propozoj që te subvencionet të përfshihen edhe shoqatat e dalura nga lufta e UÇK-së.

Labinot Shahini, diskutimet pak a shumë kaluan në çështje personale por është mirë që kjo Rregullore të përkrahet.

Ramiz Qeriqi, kërkoj që edhe fëmijët e veteranëve të UÇK-së të kenë përparësi.

Vlora Limani, subvencionet u përmendën për organizatat e dalura nga lufta që të parashihen te zyra e Kryetarit dhe është kërkesë e të gjithëve dhe subvencionet te zyra Kryetarit janë për persona juridik prandaj kategorit e dalura nga lufta janë persona juridik dhe te zyra e Kryetarit janë kriteret për ndarje të subvencioneve e të gjithë ata që i plotësojnë kriteret i realizojnë subvencionet.

Te studentët te zyra e Kryetarit nuk përfshihet nota mesatare por janë të parapara kriteret dhe në bazë të tyre të gjithë ata që i plotësojnë kushtet i realizojnë subvencionet. Te shëndetësia ku ishte propozimi që të hiqet kartela sociale si kriter unë mendoj se kartela sociale duhet të mbetet ose vërtetimi se e ka humbur asistencën sociale për shkak se fëmiu i ka mbushur 5 vite mendoj se këtu duhet të mbetet kartela sociale.

Fitim Selimi, mendoj se është pozitiv kundërshtuese propozimi i Xhevatit se nëse është përjashtu nga asistenca sociale të sillet vërtetimi se e ka humbur asistencën sociale a dihet se të njëjtin vërtetim duhet ta lëshoj i njëjti organ.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Rregullores me ndryshim që te kartela sociale të thuhet njëra ndër kriteret dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 18 për, 8 kundër, miratoi këtë:

Rregullore

Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për ndarjen e subvencioneve nga Buxheti i Komunës

Shtesë: Rregullorja.

Pas përfundimit të kësaj pike në ora 12,30 Kryesuesja dha pauzë deri në ora 13,30.

Pas pauzën në ora 13,35 pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katërt.

IV

Shqyrtimi i propozim Rregullores për shfuqizimin e Rregullores për lejet për ushtrimin e veprimtarive afariste

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Latif Ramadanit Drejtor i DEZH i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja e cila sajón pjesën përbërëse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, falënderoj Drejtorin për paraqitjen e kësaj propozim Rregulloreje për të cilën u diskutua edhe në pikën e parë dhe subjektet afariste nuk është dashtë të paguajmë këtë taksë.

Arben Bahtiri, e përkahu këtë propozim Rregullore me që është një lehtësim për bizneset.

Enver Kozhani, propozoj që bizneseve t'u hiqen obligimet e mëparshme pasi që tani janë liruar nga taksat.

Ukë Kryeziu, ne i japim një mbështetje të fuqishme kësaj Rregullore me që me këtë krijohet një klimë pozitive për bizneset e reja.

Blerim Gashi, edhe ne e përkrahim këtë Rregullore me që lirohen lehtësira për biznese mirëpo nuk mund ta përkrahim propozimin për faljen e burxheve të atyre që nuk kanë paguar me që i vëjmë në pa barazi bizneset.

Latif Ramadani, sa i përket faljes së borxheve ne nuk kemi mundësi me i fal borxhin askujt.

Me që diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Rregullore, dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat të anëtarëve prezent aprovoi këtë:

Rregullore

Për shfuqizimin e Rregullores për lejet për ushtrimin e veprimtarive afariste

Shtesë: Rregullora.

V

Shqyrtimi i Planit Vjetor të Veprimit të KKSB-së së për vitin 2014 i Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni e dha fjalën Haqif Rustemit kordinator i KKSB-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Plani i cili sajón pjesën përbërëse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Florent Hoxha, edhe na si grup parlamentar i PDK-së e kemi shqyrtuar këtë plan i cili ka të bëjë për sigurime të gjithëve, andaj kërkojmë nga Drejtorati që të bashkëpunojnë me të gjitha grupet për veprim të cilat janë të formuara në fshatra me qëllim të realizimit të këtij plani. Pastaj pyeti se a ka mjete për realizimin e këtij Plani. Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë plan.

Arben Bahtiri, këtë plan e kemi shqyrtuar edhe në KPF dhe mendoj se duhet të bëhet një fushat më intensive për sensibilizimin e kësaj çështje për pasojat e ndezjes së zjarreve dhe dëmtimit të tokave bujqësore dhe ambientit. Çështje tjetër është eliminimi i qenve endacak sepse po pësojnë fëmijët edhe gjatë shkurjes në shkollë edhe gjatë kthimit.

Labinot Shahini, ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar këtë plan dhe e përkrahim si të tillë.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim planin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht aprovoi:

Planin

Vjetor të Veprimit të KKSB-së së për vitin 2014 i Komunës së Lipjanit

Shtesë: Plani.

VI

Shqyrtimi i propozim Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni tha se përveq këtij Vendimi na kemi edhe një kërkesë nga Bashkësia Islame për heqjen e shpenzimeve të varrimit edhe në të ardhmen dhe në KPF e kemi shqyrtuar këtë kërkesë dhe rekomandimi i KPF-së është që kostoja për varrime të jetë 110 euro e jo siç e ka kalkuluar Bashkësia Islame në 265 euro, gjithashtu nga kalkulimi duhet të hiqet çertifikata e vdekjes dhe të përfshihen shpenzimet e varrimit edhe për komunitete tjera fetare.

Pastaj i dha fjalën Shkelzen Hajdinit Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbalit.

Petrit Kelmendi, unë e përkrahu këtë propozim Vendim dhe propozoj që të ndahen edhe 30 mij euro për këtë destinim kështu që për vitin 2014 të jenë 50 mijë euro dhe mjetet të lëshohen si avans Bashkësisë Islame.

Shkelzen Hajdini, Vendimi të cilin ju e keni marr nuk thuhet që ju i keni nda 50 mij euro por 20 mij euro për vitin 2013, gjithashtu edhe në buxhet nuk thuhet se këto mjete janë destinu për Bashkësinë islame.

Petrit Kelmendi, nuk dua ta ngatroj Vendimin e 2013 me 2014 se me buxhet për vitin 2014 i kemi parapa këto mjete.

Sefer Tasholli, vitin e kaluar e kemi shqyrtuar kërkesën e BI dhe i kemi nda 20 mij euro, kurse specifikimi i cili është dorëzuar tani nuk e kemi pasur. Në vazhdim tha se ne e kemi Rregulloren për varreza por kjo çështje nuk është e parapar me këtë Rregullore. Pastaj tha se ne nuk e kemi vetëm BI por kemi edhe komunitete tjera fetare dhe për këtë çështje duhet të obligohen organet kompetente për përgaditjen e Vendimit apo plotësimin e Rregullores.

Merita Zeqiri-Hajrizi, shuma prej 265 euro sipas specifikimit që e ka paraqitur BI-ja është e lartë dhe propozimi i KPF- për 110 euro mendoj se është real. Në vazhdim tha se unë e di se në disa raste BI fare nuk i ka kryer këto shërbime a sigurisht i ka kalkulue për pagesë.

Petrit Kelmendi, me buxhetin për vitin 2014 për shpenzime të varrimit janë paraparë 60 mijë euro, ku prej tyre 50 mijë euro për komunitetin Islam, kurse 10 mijë euro për komunitete tjera.

Xhavid Maholli, unë e përkrahu Petritin kur thot: se 60 mijë euro janë ndarë me buxhetin e vitit 2014. Sa i përket specifikacionit për varrim është e vërtetë se ato janë shpenzimet por ne si BI i kemi njoftuar qytetarët apo familjarët se nëse këto shërbime i bëjnë vetë atëherë BI këto mjete i ndanë familjes dhe nuk pajtohem me Meritën kur tha se në disa raste nuk janë kryer shërbimet që janë në specifikacion.

Merita Zeqiri, nga 103 që u përmendën unë do ta gjej njeriun që ka pasur rast vdekje dhe nuk ju kanë bërë këto shërbime nga BI-ja.

Blerim Gashi, edhe unë jam që kjo çështje të rregullohet me Rregullore dhe nga këtu duhet ta obligojmë organin kompetent për përgatitjen e kësaj Rregulloreje. Në KPF e kemi shqyrtuar specifikacionin e BI-së dhe kemi thënë se çmimi është i fryer.

Daut Azemi, me që tani kemi të bëjmë me ndarjen e 20 mijë eurove për ndihmë unë propozoj që ta aprovojme këtë Vendim, kurse për kërkesën e dytë propozoj që të shtyhet për një mbledhje të ardhshme.

Nazmi Krasniqi, vitin e kaluar janë realizuar 20 mijë euro edhe për këto 20 mijë euro nuk duhet të diskutojmë duhet ta aprovojme. Sa i përket Rregullores mendoj se duhet të hartohet Rregullorja.

Shkelzen Hajdini, Petriti tha se i kanë ndar 60 mijë euro për shpenzime të varrimit dhe kërkoj që ta argumentoj ky.

Petrit Kelmendi këto mjete në shumë prej 60 mijë euro për subvencione i kemi parapar te administrata me që me plan kontabël nuk pranohen. Na nuk jemi kundër Rregullores dhe jemi për hartimin e kësaj Rregullore.

Ramiz Qeriqi, pyeti se me këto mjete kujt po i ndihmohet Bashkësisë Islame apo familjeve.

Labinot Shahini, Kryesuesja e tha kuart se 20 mijë euro janë për BI por shërbimet që janë kryer, kurse çështja tjetër është se si të vendosim për të ardhmen me Rregullore të veçant .

Zoran Çirkoviq, përshëndes të pranishmit dhe si fillim e përkrahu këtë propozim Vendim dhe pajtohem me parafolësit që të nxirret një Rregullore ku do të përfshihen të gjitha komunitetet fetare.

Ukë Kryeziu, e përkrahim propozim Vendimin për ndarjen e mjeteve dhe propozoj që për mbledhjen e ardhshme të nxirret Rregullorja.

Xhavid Maholli, disa komuna këtë çështje e kanë të rregulluar me Rregullore. Me këto mjete nuk i ndihmohet BI se nuk është duke kërkuar lëmosh por këto janë obligimet e Komunës për shërbimet që ka bërë BI për ceremonitë e varrimit.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit me propozimin që për mbledhjen e ardhshme ekzekutivi të përgatit propozim Rregullore dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht aprovoi propozimin për hartimin e Rregullores dhe mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 20.000 €, (njëzet mijë) Bashkësisë Islame në Lipjan sipas kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan të datës 03.03.2014.

Shuma e cekur në paragrafin paraprak të këtij neni, i ndahet për ta mbështetur financiarisht në pagesën e shpenzimeve të varrimit të qytetarëve të Komunës së Lipjanit për të cilat theksohet se kanë mbetur të papaguara ku kostoja e përgjithshme e borjeve konstatohet të jetë për 103 raste të shërbimeve të varrimit $103 \times 265 = 27.295$.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2014 , pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të arkëtarit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, Kenan Bahtirit i cili është person i autorizuar nga Bashkësia Islame nr.1701003024438680 në NLB Bank Prishtina.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe në Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan.

Shtesë:Vendimi.

VII

Shqyrtimi i propozim Vendimit për themelimin e Komisionit vlerësues për dhënjën në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Fauz Xhemajlit Drejtor i administratës i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit i cili sajón pjesën përbërëse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Labinot Shahini, në emër të grupit parlamentar të LDK-së për anëtar të komisionit propozoj Linda Shahinin.

Florent Hoxha, propozoj Ali Stubllen.

Ukë Kryeziu, propozoj Merita Zeqirin-Hajrizi.

Blerim Gashi, me nenin 8 të këtij Vendimi është parapar pagesa e komisionit dhe me sa e di unë anëtarët e komisionit që janë të punësuar në shërbim civil nuk mund të paguhen.

Ahmet Maksuti, nga zyra ligjore, tha se këtu kemi të bëjmë me punë profesionale kurse sa i përket pagesës ne do të kërkojmë nga Ministria e financave që të bënë interpretimin ligjor lidhur me pagesën e këtij komisioni.

Feriz Hasani, kur don me punu drejt është lehtë dhe mendoj se ky komision mund të punojë edhe pa pagesë me që janë të punësuar në Komunë.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozim Vendimin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për 2 apstenime miratoi këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS
SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1
Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës (në vazhdim të tekstit: Komisioni) në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarëve, prej të cilëve tre anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, tre anëtarë nga subjektet e përfaqësuara në Kuvendin e Komunës dhe një anëtar ekspert nga Shoqëria civile.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Avni Olluri, Drejtor i Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
2. Latif Ramadani, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar
3. Ilir Tasholli, Drejtor i Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
4. Linda Shahini, LDK,
5. Merita Zeqiri, AAK-LDD
6. Ali Stublla, PDK
7. Burim Rustemi, OJQ “JETA RINORE”, anëtar

Neni 2
Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit..

Neni 3
Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit do të jetë deri përfundimin e mandatit të rregullt ligjor të anëtarëve të Kuvendit

Neni 4
Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin e Kuvendit të Komunës me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e neneve 8 dhe 9 Ligjit Nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe me dispozitat e neneve 5,6,7,8,9,10,13,14,15,16,17 dhe 18 të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5
Detyrat për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme

Komisioni në pajtim të nenit paraprak të këtij Vendimi, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së caktuar të paluajtshme të Komunës ka për detyrë dhe kryen punët, si vijon:

Në pajtim të nenit 8 të Ligjit dhe nenit 7 të Rregullores së cekur, përgatitë dhe publikon Njoftimin për Ankand publik për dhënien afatshkurtër të pronës së caktuar të paluajtshme të

Komunës i cili duhet të publikohet në Webfaqen e Komunës në vendet publike dhe në mediat lokale, elektronike dhe të shkruara.

Në afat prej 7 dite pas skadimit të afatit për parashtrimin e ofertave sipas Ankandit bënë vlerësimin e ofertave në pajtim me kriteret ligjore dhe kriteret e Njoftimit për Ankand.

Konform nenit 6 të Rregullores së cekur bën përzgjedhjen e fituesit në bazë të çmimit më të lartë të ofruar në ankand publik.

Konform nenit 10 të Rregullores harton Raportin e vlerësimit të ofertave.

Konform nenit 10 par. 3 pas aprovimit të ofertës së përzgjedhur i dërgon Njoftimin fituesit dhe publikon këtë Njoftim në Webfaqen e Komunës dhe në Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Njoftimi nga paragrafi paraparak duhet të përmbajë Udhëzimin juridik për të drejtën e pjesëmarrësve të ankandit për ankesë – Komisionit të ankesave në afat prej 15 dite nga dita e publikimit të Njoftimit..

Konform nenit 9 të Ligjit par. 6 dhe nenit 10 të Rregullores së cekur, pas skadimit të afatit për ankesa, nëse nuk ka patur ankesa ose ankesat nga Komisioni i ankesave janë vlerësuar si të pabazuara, ia dërgon Kryetarit të Komunës ofertën e përzgjedhur të fituesit në ankand bashkë me kopjen e Raportit për vlerësimin e ofertave për lidhje të Kontratës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së caktuar .

Neni 6

Detyrat për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme

Komisioni në pajtim të nenit 4 të këtij Vendimi, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së caktuar të paluajtshme të Komunës ka për detyrë dhe kryen punët, si vijon:

Në pajtim të nenit 8 të Ligjit dhe nenit 7 të Rregullores së cekur, përgatitë dhe publikon Njoftimin për Konkurs publik për dhënien afatgjatë të pronës së caktuar të paluajtshme të Komunës , i cili duhet të publikohet në Webfaqen e Komunës, në vendet publike dhe në mediat lokale, elektronike dhe të shkruara.

Në afat prej 7 dite pas skadimit të afatit për parashtrimin e ofertave sipas konkursit, bënë vlerësimin e ofertave në pajtim me kriteret ligjore dhe kriteret e Njoftimit për konkurs.

Harton rekomandimin për përzgjedhjen e ofertës sipas kriterëve për përzgjedhjen e ofertave të përcaktuara në nenin 13 të Rregullores së cekur të cilin ia bashkëngjet Raportit përfundimtar për vlerësimin e ofertave.

Konform nenit 18 par. 4 të Rregullores harton Raportin përfundimtar mbi vlerësimin e ofertave të cilit ia bashkëngjet dokumentet e parapara me Rregullore.

Konform nenit 9 par.1 të Ligjit dhe neneve 15 par.3 , 18 par. 1 të Rregullores së cekur, brenda tri dite pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave, ia dërgon Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe rekomandon për ofertën e përzgjedhur.për të vendosur në procedurë të mëtejme në pajtim me Ligjin dhe rregulloren e cekur.

Neni 7
Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj, Rregulloren e cekur dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës dhe Drejtoratet e Administratës Komunale.

Neni 8
Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një ankandi – Konkursi, do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky Vendim pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VIII
Shqyrtimi i propozim Vendimit për formimin e Komisionit të ankesave

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Drejtorit të administratës Fauz Xhemajlit i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Floren Hoxha, Ligji na obligon formimin e këtij komisioni dhe duhet të kompenzohet komisioni për punën që e kryen, mirëpo ju njoftoj se komisionet që i kemi pasur ne nuk janë paguar dhe me Ligj shërbyesit civil nuk paguhet për shkak se punët kryhen gjatë orarit të punës.

Me që diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për miratoi këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

Neni 1
Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Lumnije Ejupi, Zyra e Kryetarit të Komunës, Kryesuese
2. Ramush Asllani, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
3. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtare

Neni 2

Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Detyrat e Komisionit

Komisioni shqyrton ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës afatshkurtër dhe afatgjatë në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës .

Komisioni për ankesa bën shqyrtimin e ankesave brenda afatit prej 30 ditësh.

Neni 4

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj, Rregulloren e cekur dhe me këtë vendim do t'i ndihmojë Zyra Kryetarit të Komunës - Sektori pronësor - juridik.

Neni 5

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për shqyrtimin e të gjitha ankesave që kanë të bëjnë me procedurën e zbatimit të një ankandi përkatësisht një konkursi, do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Vendim pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të pushtetit lokal hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 15,⁴⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni